REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 329, Datë 03.11.2026

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "ARMEN SOLAR" SH.P.K. PËR REGJISTRIMIN E IMPIANTIT TË DEPOZITIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 51 të ligjit nr. 59/2026 *"Për sektorin e energjisë elektrike"*; neneve 2 dhe 8 të *Rregullave për regjistrimin në ERE të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 230, datë 18.08.2026; si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 03.11.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2718/3 prot., datë 02.11.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *"Mbi kërkesën e shoqërisë "ARMEN SOLAR" sh.p.k. për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike",*

Konstatoi se:

- Shoqëria "ARMEN SOLAR" sh.p.k., me shkresat e saj nr. AS_2026_0901, datë 08.09.2026, dhe nr. AS_ 2026_0901/1, datë 08.09.2026, protokolluar në ERE me nr. 2718 prot., datë 09.09.2026, dhe nr. 2718/1 prot., datë 10.09.2026, ka paraqitur aplikimin për regjistrimin e projektit të depozitimit të energjisë me bateri "ARMEN SOLAR 200 MW/800 MWh", në zbatim të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*" dhe vendimit të bordit të ERE-s nr. 230, datë 18.08.2026 "*Për miratimin e rregullave për regjistrimin në ERE të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar".*
- Për sa më sipër kërkuar nga shoqëria, sqarojmë se në pikat 3 dhe 5 të nenit 51 të ligjit nr. 59/2026 *"Për sektorin e energjisë elektrike"*, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 137, datë 30.06.2026, si dhe nenet 2 dhe 8 të Rregullave të miratuara me vendimin e bordit të ERE-s nr. 230/2026, parashikohet se impiantet e depozitimit të energjisë elektrike, të cilat në datën e hyrjes në fuqi të tij, kanë qenë në zhvillim ose në operim pa licencë përkatëse, njihen dhe lejohen të vijojnë operimin sipas licencës ekzistuese, me kusht që të njoftojnë dhe të regjistrohen në ERE brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit.
  Si e tillë, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 2718/2 prot., datë 14.10.2026, duke sqaruar se nga verifikimi i të dhënave të administruara pranë ERE-s, nuk rezulton që ajo të ketë një licencë ekzistuese në një nga veprimtaritë e sektorit të energjisë elektrike, ndaj i është kërkuar që të bëjë me dije bazën ligjore mbi të cilën mbështetet aplikimi i saj për regjistrimin e këtij impianti pranë ERE-s. Nga ana e shoqërisë nuk ka rezultuar të ketë pasur një kthim përgjigje.
- Për sa më sipër, vlerësohet se nuk plotësohen kushtet ligjore për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike "ARMEN SOLAR 200 MW/800 MWh" në kuadër të regjimit kalimtar, për shkak se nuk rezulton që shoqëria "ARMEN SOLAR" sh.p.k. të disponojë një licencë ekzistuese në sektorin e energjisë elektrike, në kuadër të së cilës të operojë impiantin e depozitimit gjatë periudhës kalimtare.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos miratojë kërkesën e shoqërisë "ARMEN SOLAR" sh.p.k. për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike "ARMEN SOLAR 200 MW/800 MWh", pasi shoqëria nuk disponon licencë ekzistuese në sektorin e energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "ARMEN SOLAR" sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI